

## **PROCESVERBAL**

**nga vazhdimi i parë i seancës së 32-të të Këshillit të Agjencisë për  
Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale  
mbajtur më 16.10.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional:** Maja Damevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Ivona Mufisheva, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 32-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 12:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e 2-të.

Z. Petrushevski shpjegoi se më 9 tetor Këshilli ka shqyrtuar dhe vendosi për 4 pikat e para të miratuara të Rendit të ditës. Në këtë drejtim, ai bëri të ditur se në këtë seancë do të vazhdohet me shqyrtim të Pikave nga 5 deri në 12.

## **RENDI I DITËS**

**(vazhdim)**

5. Propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
6. Propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup për shkelje të nenit 54 paragrafi (5) të LSHMAAV.
7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.
8. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.

9. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR G-TV TELEVISION SHPK Gostivar, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
10. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR G-TV TELEVISION SHPK Gostivar, për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
11. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizimit publik - shërbim: Transmetimi i të dhënave nga lokacione të largëta.
12. Të ndryshme.

### **Pikat 5 dhe 6**

Z. Petrushevski propozoi që pikat 5 dhe 6 të sqarohen me një hyrje dhe diskutim, pasi që bëhet fjalë për të njëjtën media që ka shkelur nen nga LSHMAAV dhe Ligjin për Media, dhe sipas kësaj, votimi të bëhet për secilën pikë individualisht.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, i shpjegoi propozimet për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media dhe për shkelje të nenit 54 paragrafi (5) të LSHMAAV. Ajo sqaroi se këto shkelje janë konstatuar me mbikëqyrje kontrolli. Më herët, më 12 korrik të këtij viti, transmetuesit i janë shqiptuar dy masa vërejtjeje publike, njëra për mosrespektim të nenit 14 të Ligjit për media, dhe atë për detyrimin për publikim impresium ndërsa tjetra për shkelje të nenit 54 paragrafi (5) të LSHMAAV, respektivisht ndalimi i sponsorizimit të lajmeve. Transmetuesit iu dhanë 20 ditë afat për të kryer harmonizim për çdo shkelje dhe pas kësaj periudhe janë kryer mbikëqyrje kontrolli më 26 shtator. Nga mbikëqyrjet e kryera është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike. Në lidhje me nenin 14 të LM, në ditën e analizuar, sërish nuk janë publikuar të dhënat për impresium në disa emisione të transmetuara të RA Metropolis, përkatësisht në emisionin "Një minutë fakte pozitive – sipas informacioneve të marra nga Drejtoria e Zhvillimit të Zonave Teknologjiko-Industrial dhe Këshilli i Investitorëve të Huaj " si dhe në njësitë argëtuese-informative: "Mirëmëngjesi/Mirëdita me Majën - Maja për Menopauzën dhe Gatimin" dhe "Bota në 4 me Vikin dhe Stellën", e cila bie në kundërshtim me nenin 14 të Ligjit për Media. Lidhur me shkeljen e dytë të ndalimit për sponsorizim, sërish janë sponsoruar dy emisione të lajmeve (informative) që transmetohen disa herë gjatë ditës. E para është "Metropolis Sports" e sponsorizuar nga Cevitana dhe "Një minutë lajme pozitive" sponsorizuar nga Drejtoria e Zhvillimit të Zonave Teknologjiko - Industriale dhe Këshilli i Investitorëve të Huaj" që është në kundërshtim me nenin 54 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Për këto arsye, për transmetuesin është propozuar të inicohen dy procedura për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Z. Petrushevski tha se është pak i befasuar nga veprimet e transmetuesit, sidomos për shkeljen e parë, për impresium se si i ka lejuar vetes ta bëjë këtë. Duke qenë se janë dy shkelje të ndryshme, dhe gjendja financiare e mediave është e vështirë, tha se kjo do ta realisht do të ndikojë financiarisht, por Këshilli duhet të veprojë dhe të respektojë Ligjin. Ai deklaroi se do të mbështesë të dyja propozimet.

#### Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit administrativ, nr.10-3629/1, datë 3.10.2023 dhe njëzëri konkludoi që të fillojë procedurë për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, sepse në shërbimin programor të datës 26.9.2023, të transmetuar në nivel shtetëror, SHTR Metropolis Radio SHPK Shkup si në shpçën lajmëruar se dhe në atë çlajmëruese nuk ka publikuar të dhënat për impresium në tërësinë e lajmeve me titull "Një minutë fakte pozitive - sipas informacioneve të marra nga Drejtoria për Zonat e zhvillimit teknologjiko-industrial dhe Këshilli i Investitorëve të Huaj" si dhe në njësitë argëtuese-informative: "Mirëmëngjesi/Mirëdita me Majën – Maja për Menopauzën dhe Gatimin" dhe "Bota në 4 me Vikin dhe Stellën", që është në kundërshtim me nenin 14 të Ligjit për Media.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe me pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Këshilli i Agjencisë miratoi propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje.

Sektorii për çështje juridike duhet të përgatisë Kërkesën për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup.

#### Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor, nr.10-3628/1 të datës 3.10.2023 dhe njëzëri konkludoi që të fillojë procedurë për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, sepse në shërbimin programor të datës 26 shtator 2023, transmetuar në nivel shtetëror, u sponsorizuan lajmet, respektivisht edicionet e shkurtra të emisioneve ditore informative me titull: "Sporti i Metropolit" dhe "Një minutë fakte pozitive", që është në kundërshtim të nenit 54 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuale dhe me pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Këshilli i Agjencisë miratoi propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje.

Sektorii për çështje juridike duhet të përgatisë Kërkesën për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup.

## **Pika 7**

Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë, për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkelje është konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt e bërë në gusht të këtij viti dhe shkelja ka të bëjë me detyrimin e transmetuesit për të ofruar informacione që duhet t'u vihen në dispozicion përdoruesve në mënyrë të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme. Ditën kur është kryer mbikëqyrja nuk janë publikuar këto të dhëna. Prej aty, për transmetuesin propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat respektimi prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse do të veprojë sipas paralajmërimit .

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-3355/1 të datës 1.9.2023 dhe njëzëri ka konkluduar që SHTR TELEVISION PLUS SHPK Kumanovë t'i shqiptoi masën vërejtje publike për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 10 gusht 2023 nuk ka ofruar informacionin që duhet t'i vihet në dispozicion përdoruesve.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, është udhëzuar që brenda 20 ditëve nga dita e pranimit të vendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, Spektori për Çështje Programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojnë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 8**

Udhëheqësja Janevska e shpjegoi Propozimin për shqiptim të masës vërejtjeje publike ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo ka shpjeguar se shkelja është konstatuar me mbikëqyrje të rregullt i kryer në gusht të këtij viti. Në ditën e analizuar transmetuesi në disa edicione nuk ka publikuar impresium të "TV Dnevnik" dhe "Kusi Videovesti". Për këtë arsye propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat respektimi prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe më pas të bëhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse do të veprojë sipas paralajmërimit.

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative nr.10-3356/1 të datës 1.9.2023 dhe njëzëri ka konstatuar SHTR TV ZDRAVKIN Angeçe Zdravkin, SHPKNJP Veles t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Mediat sepse më 8 gusht 2023, në pjesë të

programeve të transmetuara, nuk ka publikuar të dhënat për impresium që është i detyruar t'i transmetojë në vendin e duhur (përshtatshëm) për çdo përmbajtje të veçantë të shërbimit programor.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr. 01-4139/1 të datës 7.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, Spektori për Çështje Programore të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojnë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pikat 9 dhe 10**

Z. Petrushevski sugjeroi që pikat 9 dhe 10 të shpjegohen me një hyrje dhe diskutim pasi që bëhet fjalë për të njëjtën media që ka shkelur nenet e LSHMAAV dhe Ligjin për Media, dhe sipas kësaj votimi duhet të bëhet për secilën pikë individualisht.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Udhëheqësja Janevska sqaroi Propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media dhe për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Ajo ka sqaruar se shkeljet janë konstatuar me mbikëqyrje të rregullt programore dhe administrative të kryera në gusht të këtij viti. Lidhur me shkeljen e nenit 14 të LM, transmetuesi sqaroi se i kanë munguar të dhënat për impresium në disa përmbajtje të transmetuara në ditës e analizës, dhe shkelja e dytë është detyrimi për të transmetuar së paku 30% të programit të krijuar fillimisht si vepra audiovizuale maqedonase, dhe gjysmën nga minimumi ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase të transmetohet në periudhën prej orës 7:00 deri në ora 19:00. Ai deklaroi se në ditën e analizës media nuk ka transmetuar fare vepra audiovizuale maqedonase. Prej aty, për të dyja shkeljet, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike me afat respektimi prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse do të veprohet sipas paralajmërimit.

### **Votimi për pikën 9**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.10-3351/1 datë 1.9. 2023 dhe njëzëri konstatoi ndaj SHTR

G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media për shkak se më 10 gusht 2023, në disa prej programeve të transmetuara, nuk ka publikuar të dhënat për impresium që është i detyruar t'i transmetojë në vendin e përshtatshëm për çdo përmbajtje në veçanti nga shërbimi programor.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media .

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, Spektori për Çështje Programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë Aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi për pikën 10

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-3332/1 të datës 1.9.2023 dhe njëzëri konstatoi që SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV sepse më 9 gusht 2023 nuk ka transmetuar të paktën 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe as nuk ka transmetuar të paktën gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 7.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ( njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, Spektori për Çështje Programore të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 11**

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik, Cvetanka Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizim publik - shërbim: Transmetimi i të dhënave nga lokacione të largëta. Ajo ka shpjeguar se është furnizim që është paraparë me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë dhe mjetet sigurohen me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2023. Por duke qenë se kontrata do të lidhet për një periudhë dyvjeçare, do të duhet të parashihet dhe në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024 dhe në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2024. Sipas vlerës së parashikuar, do të zhvillohet si procedurë e hapur e thjeshtuar në përputhje me të gjitha dispozitat e Ligjit për furnizim publik, që do të thotë se shpallja do të publikohet në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për këtë furnizim (blerje) mund të gjenden në materialet e dorëzuara.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Transmetimi i të dhënave nga lokacione të largëta.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Transmetimi i të dhënave nga lokacione të largëta është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.

## **Pika 12**

### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-3637/13**

**26.10.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**